



KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Në Tiranë, sot më datën 12.12.2006 (dymijë e gjashtë) para meje Noteres Publike Eriketa KOKOLI, me seli në rrugën "Kont Uran", Nr.20, anëtare e Dhomës së Noterëve Tiranë. ndërmjet:

a) "B.N.T. ELECTRONICS" SH.P.K, me adresë: Rr. "Hoxha Tahsim" Nr.62/1, Tiranë, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.4409, datë 24.05.1994, regjistruar në Organin Tatimor Tiranë me Çertifikatën Nr.3704240 të Kodit Fiskal, e përfaqësuar nga z.Jovan BOJDANI, i biri i Todit, lindur më 11.01.1956 në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës Nr.0013458(në vazhdim i quajtur "Shitësi").

b) z. Bardhyl KËLLEZI, i biri i Isufit, lindur më 18.11.1949 në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës Nr.Z0998945, madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vazhdim e quajtur "Blerësi").

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

1. **Shitësi** ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të **583 (pesëqind e tetëdhjetë e tre) aksioneve** të regjistruara në kapitalin aksionar të shoqërisë "BANKA POPULLORE" Sh.A. Këto aksione me një vlerë nominale **100,000 (njëqind mijë) lekë** secila dhe me një vlerë të përgjithshme **58,300,000 (pesëdhjetë e tetë milionë e treqind mijë) lekë**, që janë paguar plotësisht dhe i korrespondojnë pjesëmarrjes në total në kapitalin aksionar të kësaj shoqërie, përfaqësojnë 3.95% të kapitalit aksionar të paguar.
2. **Shitësi** i shet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të një pjese të aksioneve të sipërpërmendura, dhe më saktë të **194 (njëqind e nentëdhjetë e kater) aksioneve** me një vlerë nominale prej **njëqind mijë (100,000) Lek** secili, që përfaqësojnë 1.315% të kapitalit aksionar të shoqërisë anonime "BANKA POPULLORE" Sh.A, me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre **Blerësit**, i cili e pranon këtë blerje kundrejt çmimit prej **njëqind mijë (100,000) Lekë** për aksion. Palët kontraktuese do të procedojnë njëkohësisht në regjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të shoqërisë "BANKA POPULLORE" Sh.A.
3. **Blerësi** ia ka paguar plotësisht **Shitësit** çmimin prej nentëmbëdhjet milion e katerqind mijë (**19,400,000**) Lekë.
4. **Shitësi** deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.

5. Palët bien dakort që **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj **Blerësit** në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.

6. Pas transferimit të aksioneve, **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe **Blerësi** të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë t'i zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. **Blerësi** ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.

7. Çdo mosmarrëveshje që do të lindë në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj kontrate do të shqyrtohet nga Gjykata kompetente e Tiranës.


Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë hartohet në katër (4) origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, një kopje depozitohet në Regjistrin Tregtar dhe kopja e katërt mbahet nga Noteri Publik, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë dhe mbasi deklaruan se e kuptuan e nënshkruajnë rregullisht para meje Noterit.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI


"B.N.T. ELECTRONICS" SH.P.K,

E përfaqësuar nga:

Jovan Bajdani


BLERËSI

Bandirje Kallasi


Notare Lenda
Armeta Kouch


PULLE TAKSE



100
LEKE

RISHTQPERISE